



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KRYETARI I GJYKATËS SË APELIT SHKODËR PËRBALLET ME KPK PËR MOSPAGIM TATIMESH DHE PËR DENONCIMET E QYTETARËVE

Me datë 06.05.2019, ora 10:00, u çel seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha me detyrë Gjyqtar/Kryetar i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Trupi gjykues, informon se subjekti rivlerësimit i është nënshtruar hetimit administrativ për të tri kriteret e rivlerësimit.

Sipas Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme; ka kryer deklarim të saktë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe nuk është në situatën e konfliktit të interesave.

Por pavarësisht nga konstatimet e ILDKPKI-së, KPK deklaroi se pas një analize financiare të thellë dhe të plotë, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme të ardhurash për të justifikuar pasurinë e deklaruar, por konstatoi probleme në lidhje me pasuritë e paluajtshme të cilat ishin përfituar nëpërmjet trashëgimisë nga nëna. Subjekti i rivlerësimit, nuk kishte paguar tatimet në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, në lidhje me një objekt njësi tregtare i lëshuar me qira nga ana e subjektit, pavarësisht se kjo Drejtori, nëpërmjet një vërtetimi me shkrim informon se subjekti nuk ka detyrime tatimore të pashlyera.

Në lidhje me pasuritë e paluajtshme të tjera të përfituara nëpërmjet trashëgimisë si dy apartamente dhe garazh në qytetin e Shkodrës, konstatohet mos përputhje të sipërfaqeve ndërtimore.

Referuar dy kriterëve të tjerë: të përshtatshmërisë së figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, relacioni i DSIK dhe vlerësimi profesional i KLD-së ishin pozitive për këtë subjekt.

Lidhur me denoncimet nga publiku, për subjektin e rivlerësimit ka pasur 14 denoncime. Sipas KPK, një pjesë e tyre, nuk përmbajnë elemente konkrete shkeljesh. Megjithatë, në këtë seancë dëgjimore, KPK u ndal në analizën e disa denoncimeve, ku për një prej vendimeve gjyqësore në të cilën subjekti ka qenë kryesues i trupës gjykuese, Gjykata e Lartë e ka prishur këtë atë. Në një denoncim tjetër, subjekti i rivlerësimit kishte zvarritur procesin gjyqësor duke kaluar afatet kohore të gjykimit.

Subjektit të rivlerësimit iu dha e drejta për tu mbrojtur dhe për të paraqitur parashtrimet dhe prapësimet e tij në seancën dëgjimore të zhvilluar nga KPK. Subjekti u shpreh se e gjen me vend arsyetimin e Gjykatës së Lartë për prishjen e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Shkodër, pavarësisht bindjes së tij të brendshme. Megjithatë, subjekti mbrojtë pozitën e tij sa i takon vonesave të pretenduara për gjykimin e dosjeve pranë Gjykatës së Apelit si pasojë e ngarkesës së lartë dhe mungesës së gjyqtarëve. Ai vuri në dukje karrierën e tij të gjatë në sistemin e drejtësisë, prej 25 vitesh, i ardhur nga një familje e persekutuar politikisht nga regjimi i mëparshëm, duke evidentuar pastërtinë e figurës së tij nga ana morale dhe asaj profesionale.

Vërehet se KPK, nuk analizoi gjatë kësaj seance performancën e subjektit të rivlerësimit në detyrën si Kryetar i Gjykatës së Apelit Shkodër, por vetëm atë të Gjyqtarit.

Në fund të seancës dëgjimore pas 2 orë e 40 minutave trupi gjykues i dha fund hetimit gjyqësor dhe caktoi datën 08 Maj 2019 për shpalljen e vendimit.